



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1550/8 Prot.

Tiranë, më 13.06.2023

VENDIM

Nr. 68 dt. 13.06.2023

PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË
KOMISIONIT TË KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përherëshëm, në Nivel Institucioni, të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, nenit 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2023,

V E N D O S I :

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, me këtë përbërje:
 - 5 (pesë) anëtar nga personeli akademik i UST-së, që i përkasin kategorisë “profesor”;
 - 1 (një) anëtar përfaqësues i stafit administrativ;
 - 1 anëtar përfaqësues i studentëve;
2. Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së për 7 (shtatë) ditë pune, nga data 14.06.2023 deri në 22.06.2023.
3. Kandidatët e interesuar, në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.

4. Sekretari i Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

